




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0014451-9/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë



Në bazë të neneve 12, paragrafi 2, alineja d, dhe 17, pika k, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenet 3, paragrafi 4, dhe 40, paragrafi 2, nënparagrafi 2, të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 27.03.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për subvencionimin e familjeve Peci dhe Avdyli për humbjen e familjareve të tyre në aksident trafiku në Itali

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë të përgjithshme prej 6,000.00 €, (gjashtëmijë), respektivisht me nga 3,000.00 € (tremijë €) për mbështetje financiare (subvencionim) për familjet Peci dhe Avdyli.
2. Mjetet financiare të ndara sipas pikës 1, të këtij Vendimi shërbejnë për ofrimin e ndihmës familjeve të lartëcekura, duke vlerësuar gjendjen emocionale dhe sociale të familjeve pas humbjes tragjike të jetës së familjarëve të tyre Fidan Peci dhe Adrian Avdyli në aksident trafiku në Itali.
3. Mjetet nga pika 1, e këtij Vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe transferohen në llogarinë bankare të anëtarëve të prindërve të caktuar nga familja Peci dhe Avdyli:
 - 3.1 Shuma prej 3,000.00 € (tremijë) transferohen në llogarinë bankare të z. Aziz Peci (Nr. pers.1007261191) në llogarinë Nr. 20-27-0002249441-80 Banka TEB.
 - 3.2 Shuma prej 3,000.00 € (tremijë) transferohen në llogarinë bankare të znj. Mërita Avdyli (Nr. pers.1004865851) në llogarinë Nr. 1405000150194391 Banka Ekonomike SH.A.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës, respektivisht Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për Mirëqenie Sociale

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa